

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtarës Mevlide Shabani, me bashkëpunëtorën profesionale Vlora Selmani - Rahimi, në çështjen juridiko-civile të paditësve M. K. M. K.1., E. K dhe J. K të gjithë nga,.... të cilët me autorizim i përfaqëson av...., kundër të paditurit D. S. nga ish rruga ,.... pa.nr, tani me adresë të panjohur , të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av...., për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.22.08.2016 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve,të gjithë nga...., dhe **VËRTETOHET**, se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës interne të shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim të këtyre ngastrave kadastrale me sa vijon:

Paditësi M. K , i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën e re kadastrale me nr.në sipërfaqe të përgjithshme prej

Paditësi J. K i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën e re kadastrale me numër në sipërfaqe të përgjithshme prej

Paditësi E. K. i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën e re kadastrale me numërnë sipërfaqe prej..'

Paditësi M. K. i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën e re kadastrale me numërnë sipërfaqe të përgjithshme prej ...të cilat ngastra gjenden në vendin e quajtur ...

II. Ngastra e re kadastrale me numërnë sipërfaqe të përgjithshme prej ...e cila shfrytëzohet si rrugë private mbetet në bashkëpronësi me nga $\frac{1}{4}$ në emër të M. K M.:K2 $\frac{1}{4}$, E. Ki dhe J. K .

Këto ngastra ngastra janë pjesë e ngastrave kadastrale me nr:....të gjitha në vendin e quajtur ,, ,, ZK-....

III. DETYROHET i padituri t ia njoh dhe pranojë paditësve të drejtën e pronësisë ashtu që paditësit të regjistrohen si pronarë juridik në pasurisë kontestuese, në DGJKPB, në Gjilan, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

1.Kompetenca e gjykatës:

Kompetenca territoriale e gjykatës është përcaktuar në bazë të nenit 41.1 të LPK, lidhur me kompetencën territoriale ekskluzive, meqë paluajtshmëria kontestuese gjendet në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, kurse kompetenca lëndore është përcaktuar në bazë të nenit 29 të LPK.

Paditësit,..... , në gjykatë kanë paraqitur padi me datë 31.01.2014, pasi që prindërit e tyre në vitin ngastrat kontestuese i kishin blerë nga i padituri D. S me çmimin e përgjithshëm prej 610.000 dinar të atëhershëm (me kundërvlerë të tanishme rreth 40.000 mijë)Euro, të cilën shumë të parave ja kishin paguar menjëherë pas lidhjes së kontratës për shitblerje dhe disa herë kishin tentuar që përmes rrugëve jashtëgjyqësore ta zgjidhin këtë çështje mirëpo për shkak të ndryshimit të rrethanave në Kosovë, respektivisht ndërrimin e adresës së të paditurit nuk kishin arritur kontakt me të njëjtin, ndërsa menjëherë pas blerjes de facto kishin hyrë në shfrytëzim dhe posedim të këtyre ngastrave dhe kanë ndërtuar 4 shtëpi banimi të cilat vazhdojnë të shfrytëzojnë pa i penguar askush as nga i padituri apo ndonjë person i tretë.

Gjykata në mungesë të paditurit D.S.me date, ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm të të paditurit av . G. S. nga

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, përfaqësuesit të përkohshëm i ka dërguar padinë , në mënyrë që i njejtë të paraqes përgjigje në padi, ku përfaqësuesi i përkohshëm, ka ushtruar përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve.

Paditësit e lartëcekur në seancën përgaditore të datës 18.06.2016 njëzëri deklaruan se i japin autorizim av.... nga për përfaqësimin e tyre në këtë çështje juridiko-civile.

Ne shqyrtimin përgaditor ,përfaqësuesi i paditësve av.ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë duke cekur se diku në vitin 1962 paditësit përkatësisht prindërit e tyre i kishin blerë ngastrat e lartëcekura nga i padituri D. S, duke theksuar se në këto ngastra menjëherë kishin hyrë në posedim të pa penguar nga askush, gjykatës i ka propozuar që të ftohet eksperti gjeodet që të dalin në vendin e ngjarjes me qëllim të konstatimit të gjendjes në terren , si dhe të ftohen dëshmitaret si dhe R. M.të gjithë nga

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit D.S av. G. S nga ka deklaruar mbetet pranë përgjegjës në padi lidhur me këtë çështje kontestimore .

Gjyqtarja e çështjes në seancën gjyqësore të mbajtur në vendin e ngjarjes me datë 13.06.2016 ka konstatuar se të pranishëm ishin përfaqësuesi me autorizim i paditësve av....., përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av.si dhe eksperti gjeodet B. K ku ekspertin gjeodet e obligoj që të bëjë konstatimin e gjendjes faktike.

Dëshmitaringa....., ka deklaruar se me paditësit është fqinj dhe paljutshmërinë kontestuese prindërit e paditësve e kishin blerë në vitin 1962, nga i padituri ndërsa paditësit menjëherë kanë hyrë në shfrytëzim dhe posedim të cilat ngastra fillimisht ishin të punuara me detelinë, ndërsa më vonë kanë ndërtuar edhe objekte banimi, pa i shqetësuar apo penguar askush.

Dëshmitaringa, ka deklaruar se në vitin 1962 kishte qenë fëmijë , mirëpo i kujtohet se ngastra kishte qenë e punuar si arë me detelinë ngase në të njëjtën kohë edhe prindërit e

tija ty afër e kishin blerë një parcelë , ku kishte ndërtuar shtëpi e pastaj edhe paditësit kishin ndërtuar shtëpitë e tyre , i cili ka shtuar se askush nuk i ka shqetësuar apo penguar paditësit.

Paditësii dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se që nga viti 1962 babai i tij së bashku me axhallarët e tij e kishin blerë ngastrën kontestuese nga i padituri D. S e cila ngastër ishte shfrytëzuar si arë , e të cilën e kishin ndarë sipas marrëveshjes interne e në të cilën kanë ndërtuar shtëpi banimi e shfrytëzojnë që nga ajo kohë e deri më sot të pa penguar nga askush .

Paditësii dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se babai i tij së bashku me axhallaret e tij në vitin 1962 e kishte blerë ngastrën kontestuese prej të padituritdhe fillimisht është shfrytëzuar si arë e pastaj kanë ndërtuar edhe shtëpitë e tyre si dhe e kanë bërë ndarjen ekonomiko – familjare sipas marrëveshjes, dhe në fund ka shtuar se babai i tij dhe axhallaret nuk kanë qenë të penguar apo shqetësuar nga askush , po ashtu edhe tani paditësit vazhdojnë ta shfrytëzojnë pjesët e tyre sipas marrëveshjes.

Paditësi E. K i dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se kur është blerë palujtshmrëia kontestuese ka qenë fëmijë mirëpo i kujtohet se paraardhësit e tij e kishin blerë këtë ngastër në vitin 1962 dhe menjher kishin hyrë në posedim dhe shfrytëzim , ku edhe kishin ndërtuar shtëpi e që edhe sot e tutje vazhdojnë ti shfrytëzojnë të pa penguar nga askush dhe ne fund ka cekur se faktikisht janë pronar , mirëpo dëshrojnë të jenë dhe juridikisht pronar .

Paditësi J. K i dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se gjyshi i tij e kishte blerë ngastrën kontestuese së bashku me vëllezërit e tij ku fillimisht ishte shfrytëzuar si arë , e pastaj kishin ndërtuar edhe shtëpi dhe mes vete asnjëherë nuk kishin pas mosmarrëveshje rreth shfrytëzimit të ngastrës .

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata ka analizuar deklaratat e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve dhe i ka administruar të gjitha provat dhe shkresat e lëndës si vijon;

Leximi i kopjes së planit me numëre datës..., çertifikata mbi të drejtat e pronës së palujtshme me numër të njësisë P.....- e datës., çertifikata mbi të drejtat e pronës me nr të njësisëdatës.....,çertifikata me numër të njësisëe datës.....,certifikata me numër të njësisë ...e datës....., që të gjitha në emër të D. S në vendin e quajtur ,, R... ,, ZK , mendimi dhe konstatimi i ekspertëve gjeodet së bashku me skicën me numër i datësi punuar nga..... .

Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësve av.ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara, dëgjimi i dëshmitarëve si dhe paditësve të dëgjuar në cilësi të palës dhe ekspertiza e ekspertit gjeodet është vërtetuar fakti se prindërit e paditësve që nga viti 1962, e kishin blerë pasurinë kontestuese në shume prej 610.000 mijë dinar të atëhershëm, nga i padituri D. S , të cilit nuk i dihet adresa e saktë e që nga ajo kohë e kanë paditësit në shfrytëzim dhe posedim pa i penguar askush, duke shtuar se edhe në bazë të mbajtjes me mirëbesim për më shumë se 20 vite dhe mbi bazën e ndërtimit i propozoj gjykatës që paditësve tu njihet e drejta e pronësisë në bazë të precizimit të kërkesëpadisë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve av.... ka deklaruar, se pas dëgjimit të dëshmitarëve, daljes në vend të ngjarjes së ekspertit gjeodet dhe administrimin e të gjitha provave tjera, i la gjykatës që të vendos në lidhje me pretendimet e palëve paditëse dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore .

Lidhur me këtë gjykata e vërtetoi gjendjen faktike se ka ekzistuar raporti juridiko civil mes palëve ndërgjyqëse sipas kontratës për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme në mes të paditurit D S si shitës në njërin anë dhe prindërve të paditësve - tani paditësvesi blerës në anën tjetër, gjykata këtë e vërtetoi në bazë të çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me numër të njësisë P-....., çertifikatës mbi të drejtat e pronës me nr. të njësisëe datës....., çertifikatës me numër të njësisëe datës....., çertifikatës me numër të njësisë e datës....., që të gjitha në emër të D. S në vendin e quajtur ,, R,, ZK Gjilan, po ashtu në bazë të kopjes së planit me numërku paditësit shihet se kanë të ndërtuar shtëpi banimi e të cilat i kanë në shfrytëzim dhe posedim, si dhe deklarata e dëshmitarëve, ..., të cilët në mënyrë të kuartë kanë deklaruar që paditësve tu njihet e drejta e pronësisë në këto ngastra kadastrale si dhe deklaratat e paditësve të dëgjuar në cilësi të palës të cilët njëzëri deklaruan se familja e tyre asnjëherë nuk kanë qenë të penguar apo shqetësuar nga askush si dhe nga konstatimi i ekspertit gjeodet, i cili në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka bërë konstatimin me skicën e hartuar, me date..., gjykata e ka vërtetuar faktin se eksperti e ka studiuar dhe konstatuar mirë gjendjen faktike, ndërsa të dhënat lidhur me historikun e pronës i ka marr dhe lexuar nga padia fillestare që i ka transferuar në konstatimin e tij, për çka ato të dhëna që i ka përmendur eksperti vetëm se kanë kompletuar gjendjen reale për këto ngastra kadastrale dhe në bazë të nenit 28 të LTHMJP paditësit mbi 20 vite e mbajnë pasurinë kontestuese, e kanë në posedim-shfrytëzim të ligjshëm dhe me mirëbesim, të pa penguar nga i padituri, familja e tij apo personat tjerë dhe nga baza e parashkrimit fitues paditësve u njihet e drejta pronësisë për pasurinë kontestues si në dispozitiv **I** të këtij aktgjykimi, ndërsa ngastrën e re kadastrale me numër në sipërfaqe të përgjithshme prej 233m² e cila shfrytëzohet si rrugë private gjykata vendosi si në dispozitivin **II** të këtij aktgjykimi që të mbetet në bashkëpronësi me nga 1/4 në emër të1/4, ..1/4, E.K.

Nga të cekurat më lart, në bazë nenit 28 të LTHMJP, nenit 143 par.1, të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitivin **I** dhe **II** të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Më dt.22.08.2016

Gjyqtarja

Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje mjaftuara përmes kësaj Gjykate.

